



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 153/5 Prot.

Tiranë, më 22/04/2014

U R D H E R

Nr 10 ,datë 22/04/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Tirana International Airport" sh.p.k (TIA), Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 21 datë 04.02.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Tirana International Airport" sh.p.k (TIA) Tiranë, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Tirana International Airport" sh.p.k i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në fushën e transportit ajror të pasagjerëve.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. "Tirana International Airport" sh.p.k në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues privat i cili kryen aktivitetin e tij në fushën e projektimit, financimit, ndërtimit, funksionimit, menaxhimit dhe zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe Terminalit të Ri në kuadër të kontratës konçensionare me Qeverinë Shqiptare.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë klientë (pasagjerë) të transportit ajror, punonjës dhe furnitorë si: emri, mbiemri, gjinia, mosha, imazhe, datëlindja, vendlindja, atësia, amësia, gjendja penale, adresa, numri i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, foto, numri i telefonit, e-mail, të dhëna shëndetësore, shenjat e gishtave, formimi profesional, trajnime, si dhe informacione për klasin e udhëtimit, itinerarin, destinacionin, numrin e vendit në avion etj.

1. Kontrolluesi mban në dosjet personale të punonjësve dokumente që mbartin të dhëna personale të punonjësve të larguar (*të cilët nuk kanë probleme gjyqësore dhe financiare pas mbarimit të marrëdhënies të punës*), për një kohë më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej, duke shkelur nenin 5/1/d të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat biometrike të punonjësve (*shenjat e gishtave*), me qëllim kontrollin e disiplinës të hyrje-daljeve në ambientet e punës, të cilat ruhen për një afat kohor prej 1 viti, duke shkelur nenin 5/1/d të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 (pika 9.4) “*Mbi përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat*” të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ku thuhet...“*të dhënat biometrike të mbledhura nuk mund (si rregull) të ruhen për një hark kohor më shumë se 7 ditë dhe duhet të sigurohen kur ky hark kohor mund të jetë ligjërish i zgjatur ,me mekanizmat e duhura të fshirjes automatike të të dhënave*”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se të dhënat personale të punonjësve grumbullohen, përpunohen dhe përdoren vetëm për qëllime të krijimit, implementimit, ndërprerjen ose administrimin e marrëdhënies midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kontrolluesit mund t'i mbajnë të dhënat personale vetëm për aq kohë sa ata kanë nevojë për to, lidhur me qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur dhe përpunuar më tej. Sapo të dhënat të mos jenë të nevojshme, kontrolluesit duhet t'i shkatërrojnë, duke mbajtur parasysh kërkesat ligjore. Të dhënat nuk duhet të mbahen “*sa për ti pasur*” me mendimin se kontrolluesve “*mund t'u duhen përsëri*”. Me ndërprerjen e marrëdhënies të punës të dhënat e punonjësve nuk janë më të nevojshme për këtë qëllim, prandaj ato duhet të shkatërrohen.

2. Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejimit, ku të parashikohen rregulla mbi administrimin e këtyre të dhënave, të drejtat e aksesit që kanë operatorët e ndryshëm. Në ambientet e terminalit të pasagjerëve dhe mjedise të tjera, ku janë instaluar një pjesë e kamerave, nuk janë vendosur tabela informuese për publikun, lidhur me përdorimin e sistemit të video-survejit. Në këtë rast janë shkelur nenet 18, 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 3 datë 05.03.2010 “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit për përdorimin e sistemit të video survejimit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit, i të dhënave personale. Tabelat informuese duhet të vendosen në vende të dukshme të ambienteve ku përdoret sistemi i video survejimit. Hartimi i një rregulloreje të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale që përpunohen përmes përdorimit të sistemit të video survejimit është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi duhet të zbatohen nga kontrolluesi.

3. Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, nuk ka aplikuar praktika për të informuar “*punonjësit*” për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre. Në faqen e tij në internet www.tirana-airport.com.al, nuk janë publikuar “*politikat e privatësisë*” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e

sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Në këtë rast është shkelur neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mblidhen nga individët e interesuar, informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqes në internet të kontrolluesit, duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private

4. Në kontratën e lidhur midis TIA dhe Hewett-Packard (Schweiz) GmbH, për mirëmbajtjen e serverave të sistemit, nuk parashikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me aksesin në të dhënat personale, sigurinë e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit, duke shkelur nenin 20 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se përcaktimi në kontratë i detyrimeve për përdorimin e ligjshëm dhe të siguritë të të dhënave personale është detyrë parësore e kontrolluesit. Ligjshmëria, siguria dhe konfidencialiteti për përdorimin e të dhënave personale nga përpunuesi të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.3.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe akteve të Komisionerit duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgim dhe kontroll nga ana e kontrolluesit.

5. Kontrolluesi nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale që ai mbledh, përpunon dhe ruan, duke shkelur në këtë rast nenin 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesin në të dhënat personale etj. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe nenet 107-109 të K. Procedurës Administrative :

U R D H E R O J

I. Në zbatim të nenit 5 pika 1/d të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar:

- të hiqen nga arkiva dhe të shkatërrohen dokumentet pjesë e dosjeve individuale të punonjësve (*që mbartin të dhëna personale*), të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe nuk kanë probleme gjyqësore apo financiare.

2. Në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat*" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- të dhënat biometrike të mbledhura të ruhen për një kohe jo më shumë se 7 ditë duke përdorur mekanizmat e duhura të fshirjes automatike të të dhënave.
- të dhënat biometrike të mbledhura që kanë kaluar afatin prej 7 ditësh të fshihen nga sistemi.

3. Në zbatim të neneve 18, 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- në vende të dukshme në ambientet e terminalit të pasagjerëve dhe mjedise të tjera, ku janë instaluar një pjesë e kamerave, të vendosen tabela informuese për publikun, lidhur me përdorimin e sistemit të video-survejimit.
- të hartohet një rregullore lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejimit, ku të parashikohen rregulla mbi administrimin e këtyre të dhënave, të drejtat e aksesit që kanë operatorët e ndryshëm, kohën e ruajtjes etj, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar:

- të informohen "*punonjësit*" për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale të tyre, për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, për të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim etj.
- në faqen tuaj në internet www.tirana-airport.com.al, të publikohen "*politikat e privatësisë*" (*paketë rregullash*), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opinionin "*Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat*" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.

5. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar:

- në kontratën e lidhur midis TIA dhe Hewett-Packard (Schweiz) GmbH, për mirëmbajtjen e serverave të sistemit, të parashikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me aksesin në të dhënat personale, sigurinë e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

6. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen,

përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

7. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Urdhëri.

8. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

